



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL XIII/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (njëmbëdhjetë) të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 22.12.2023
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyçi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 6. Njoftim për kontratat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

Resahat Selimaj - dua të shtoj një pikë shtesë rreth meditjes së komisionit të aksionarëve në stacion.

Festë Kabashi - edhe unë do ta kisha shtu si pikë të rendit të ditës nëse e kërkon procedura.Kam kërkesë me e ndryshu orarin e seancave që po mbahen.

Kryesuesi - faktikisht e kemi në plan të punës dhe e diskutojmë.E hedh në votim pikën shtesë që kërkoi Reshat Selimaj.

**20 për,7 apstenime
Miratohet pika shtesë**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Me 28 vota për Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe ia uron festat e fundvitit të gjithëve.

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatim.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që muajin tetor është miratu rregullorja por dy ministri e kanë kthi në rishqyrtim me disa kërkesa të vogla.Komuna sipas Ministrisë së Planifikimit hapsinor dhe konkretisht sipas ligjit për planifikimin hapsinor ka qenë e obliguar që për çdo vit paraprakisht të merr pëlqimin për taksën për leje ndërtimore e që ne e kemi taksën e lejës ndërtimore të

vitet 2019 mirëpo që nga viti 2019 e deri më tani asnjëherë nuk është bërë kërkesë në MAPL për të marrë pëlqimin paraprak. Në tash e kemi bërë kërkesën dhe e kemi marrë pëlqimin nga MAPL që taksa e vitit 2019 për lejet ndërtimore të aplikohet edhe për vitin 2024. Është kthyer edhe për dy çështje tjera të cilat ne kemi menduar që janë të rregulluara me akte nënligjore dhe nuk e kemi inkuorpuar në kuadër të rregullores për tarif ngarkesa çështjen e lejes për taksën mjedisore. Në tani këto tarifa i kemi inkuorpuar në kuadër të rregullores.

Shefket Kolgeci - a do të shkon individi me marrë pëlqimin atje apo Komuna duhet të marrë pëlqimin për vitin paraprak dhe mandej këto aplikohen në Komunë. Do të thotë nuk ka nevojë me shku në Prishtinë.

Avni Bytyqi - ligji për planifikimin hapsinor dhe udhëzimi administrativ i vitit 2018 i jep kompetencë Komunës ta cakton taksën për leje ndërtimore dhe leje të rrënimit të objekteve mirëpo një dispozitë ligjore kërkon që Komuna për çdo vit ta njoftoj ministrinë se edhe për vitin vijues do ta aplikoj të njejtën taksë. Siq thashë Ministria e Shëndetësisë është duke punuar me një udhëzim administrativ të vitit 2007 i cili i përcakton taksat për shërbimet e kujdesit në QKMF dhe në qendrat ku u ofrohet qytetarëve shërbimi parësor dhe i përcakton se cilat kategori lirohen. E dini që prej vitit 2007 ka ndryshu legjislacioni, ka ndryshu infrastruktura ligjore për shumë çështje dhe ne iu kemi referuar ligjeve që kanë dal prej vitit 2008 deri në vitin 2023 duke inkuorpuar të gjithë personat që kanë të drejtë të lirohen nga taksa. Ministria na ka kthyer në rishqyrtim që ju duhet ti përmbahemi udhëzimit administrative 04/2007 për të cilat i përcakton kategoritë që lirohen. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime

Sanie Kuçi Rexhepaj - kam dy kërkesa për ekzekutivin. Në fazën që është duke u hartu një rregullore dhe hapin diskutime apo shqyrtime publike, të na njoftojnë zyrtarisht edhe neve si Kuvend për shkak se ne po e japim vulën përfundimtare të secilës rregullore apo dokumenti. Kërkesa tjetër është që nëse ka mundësi ekzekutivi me i largu këto arsyetimet klishe (që po na duhet shumë shpejt me miratu këtë rregullore). Në në KPF kemi kërku që vetëm një seancë me u shty miratimi i kësaj rregullore që me u diskutu rekomandimet tona dhe arsyetimi ishte që po na duhet shpejt me miratu rregulloren dhe tash ministria e shty dy seanca. Falemderoj komisionin që i ka marrë për bazë disa nga kërkesat e mia që i kam parashtrur në KPF dhe të cilat janë të arsyeshme.

Kryesuesi - do ta marrim parasysh kërkesën tënde që në të ardhmen të ju informojmë nëpërmjet email adresave.

Shefket Kolgeci - mbledhjen e kaluar këtë projekt-rregullore grupi jonë parlamentar nuk e kemi votu. E kemi pas një kërkesë në këtë rregullore dhe ne prap i qëndrojmë asaj kërkesë. I bëj apel kolegëve asambleist që të shqyrtojnë edhe një herë mendimet e tyre. Ne kemi kërku që taksa komunale në biznese të hiqet. Pothuajse vetëm Komuna jonë e ka këtë taks dhe gjithëashtu kam sugjerime prej qytetarëve dhe bizneseve që taksa të eliminohet. Nëse kërkesa jonë aprovohet ne do ta votojmë por nëse nuk aprovohet kërkesa jonë, ne nuk do ta votojmë.

Dardan Berisha - Në këtë seancë shumica e pikave dhe rekomandimeve janë për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe realisht unë po e shoh në portale që ajo në çdo aktivitet politik që i takon shëndetësisë është prezente mirëpo këtu nuk është prezent dhe as në KPF. Shqetësuese mbetet edhe sot prania e drejtorave. Trifa për diplomë të përfundimit të shkollimit të mesimit jo formal ka qenë 20 € mirëpo tash me ndryshimin e rregullores nuk qenka kjo tarifë. A është duke vazhdu mësimi jo formal apo nuk është duke vazhdu?

Nënkryetarja - mësimi jo formal aktualisht nuk është duke vazhdu për arsye se mësimi jo formal është zhvilluar vetëm në shkollën e mesme teknike. Mund të ndodh viteve tjera me u organizuar por për momentin nuk është duke u vazhdu.

Dardan Berisha - ne duhet me pas një raport se deri ku ka shku pjesmarrja e mësimi jo formal dhe te rregullorja e re nuk po shoh tarifë.

Avni Bytyqi - besoj që ka por ka ndryshu udhëzimi administrative së fundi dhe i ka përcaktuar tarifat e reja për mësimet plotësuese. Te 1.1, 1.2 dhe 1.3 janë pikërisht për këtë çështje.

Labinot Halitjaha - dua të lidhem te taksat në aktivitet sepse është hera e tretë që po diskutohet dhe dy herë nuk ka kalu. Tatimi është baza e një Komune. Ne mbledhjen e kaluar vetëm e larguam tatimin në pronë për Komunën tonë për vitin 2023 e cila do të ndikojë në 2024 afërsisht rreth 600.000€ ku është bazë e investimeve kapitale të Komunës dhe nëse tash i largojmë edhe taksat.

Shefket Kolgeci - unë nuk thashë për tatimin në pronë por ishte konkret për taksa. Taksat në aktivitet ka mundësi me u heq sepse asnjë Komunë nuk e paguan.

Labinot Halitjaha - nëse hiqen edhe taksat në aktivitet ndikojnë rreth 1.000.000€ dhe nuk është e vërtetë që taksat në aktivitet janë të hequra në të gjitha Komunat. 50 % e Komunave e kanë taksën në aktivitet.

Shefket Kolgeci - unë mendoj që është qëllim sepse e ka propozu gr. i LDK-së dhe nuk do ta votoni sepse i keni numrat.

Labinot Halitjaha - nuk është e rrugës sidomos për vitin e ardhshëm.

Urim Suka - kur jemi duke fol për taksat në aktivitet është e vërtetë që nëse merret vendimi që ato të hiqen, normalisht që do paret kanë me qenë ma pak në buxhetin e Komunës të të hyrat vetanake por ato para në njërin anë kanë me qenë te qytetarët, te bizneset. Ta keni parsysh që propozimi jonë nuk është thjesht me i heq taksa për dikënd por është për me iu ndihmu sidomos bizneseve të vogla dhe të mesme. Unë kërkoj që propozimin që bëri Dr. Shefketi të merret seriozisht, jo si një propozim i një grupi parlamentar të opozitës por si propozim që iu bie mirë bizneseve sidomos të vogla dhe të mesme. Në anën tjetër, me plotëni e mbështes fjalën e Sanies për ato që i tha te KPF dhe nëse ishin marrë parasysh vërejtjet tona atëherë, ne nuk ishim vonu me këtë rregullore dy-tre muaj por me një muaj vonesë ndoshta e kishim bërë një rregullore që s'ka pas nevojë me u kthyer. Fatkeqësia është që këto vendime po na kthejnë në vazhdimësi.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e grupit të LDK-së.

8 për, 10 kundër, 10 apstenime
Nuk kalon propozimi

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

18 për, 11 apstenime
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe kërkon nga grupet parlamentare propozimet.

Aziz Bytyqi - ne si grup i AAK-së propozojmë Saranda Bajraktari.

Urim Suka - ne si grup i LDK-së propozojmë Kushtrim Kuçi.

Qëndrim Elshani - grupi i LVV-së propozon Laureta Tafaj.

Dardan Berisha - Grupi i PDK-së nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi - ne si NISMA nuk kemi propozim.

Herolind Limaj - ne si Iniciativa Qytetare nuk kemi propozim.

Kryesuesi - pasi kanë dalë tre emra ne do të shkojmë veq e veq për secilin dhe dy prej tyre që kanë më shumë vota do të futen në komision. E hedh në votim propozimin e AAK-së për Saranda Bajraktarin.

21 për, 8 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së për Kushtrim Kuçin.

10 për, 16 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LVV-së për Laureta Tafaj.

18 për, 7 apstenime

Kryesuesi - në bazë të votave është Saranda Bajraktari dhe Laureta Tafaj. Kryesuesi kërkon nga nënkryetarja edhe tre emra, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Nënkryetarja - prej ekzekutivit propozojmë Albulena Kokollari dhe Armend Krasniqi si dhe nga shoqëria civile është Aida Kuçi.

Kryesuesi - i hedh në votim anëtarët e komisionit me këtë përbërje: Saranda Bajraktari, Laureta Tafaj, Albulena Kokollari, Armend Krasniqi dhe Aida Kuçi.

20 për, 1 kundër, 5 apstenime
Miratohet formimi i komisioni

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - në emër të grupit të PDK-së propozoj që seancat e rregullta të Kuvendit me vazhdu në ora 13:00 siq kanë qenë më herët.

Urim Suka - në kuadër të planit të punës personalisht e mbështes që seancat të mbahen prej orës 13:00. Në KPF i kam pas disa propozime për planin e punës ku njëri prej propozimeve ka kalu dhe propozimet tjera nuk kanë kalu. Unë mendoj që ne si Kuvend i Komunës duhet me marrë pak më shumë kompetenca për rolim që e kemi, sidomos duke marrë për bazë situatën në të cilën ndodhemi, me mënyrën si po qeveris ekzekutivi. Për shkak të shumë situatave dhe shumë skandaleve që kanë ndodhë, unë mendoj që Kuvendi duhet me marrë rolin e vet mbikqyrës për me ndihmu që punët që bëhen, të bëhen sa ma mirë dhe në interes të qytetarëve. Ne mendojmë që brenda planit të punës, për muajin janar me hy edhe formimi i disa komisioneve mbikqyrëse. Në kuadër të kësaj mendoj që planit të punës me iu shtu formimi i komisionit për mbikqyrjen e listës së investimeve kapitale se si po menaxhohen dhe si po ekzekutohen në teren, një komision për arsim, një komision për shëndetësi, një komision për bujqësi dhe një komision për urbanizëm, planifikim dhe kataster. Këto komisione është mirë me u inkorporu dhe me u formu dhe me pas mandat brenda një viti dhe vitin e ardhshëm në janar me u formu këto komisione me anëtar të rinjë dhe si Kuvend me mbikqyr pak më mirë këtë qeverisje e cila mendojmë që ka degradu sidomos vitin e fundit me aktakuza e gjëra që janë ngritur.

Bulëza Kuçi - edhe unë e përkrahi kërkesën e Dardanit për ndërrimin e orarit për takimet e Asamblesë. Unë dhe Urimi jemi munduar ti japim disa kontribute tona për ti shtuar në tabelën e punës së Asamblesë mirëpo përveq një kërkesë të përbashkët që e kishim me Daranin, kërkesat tjerat nuk janë pranuar. Andaj po provoj edhe sot ti inkorporoj edhe kërkesat tjera. Unë kisha si kërkesë që çdo muaj ose në muajt përkatës secila drejtori të jep informata të posaqme. Gjithëashtu kërkesë e imja ishte që seancat solemne të mbahen në Asamble, p.sh. Dita e çlirimit, Dita e pavarësisë dhe Dita e 28 Nëntorit.

Festë Kabashi - sa i përket orarit të seancave nga viti 2024 po shpresoj që të gjithë e trajtojnë seriozisht dhe e votojnë pro, të paktën shumica. Sa i përket idesë së kolegut Suka edhe unë e mbështes. Kisha kërku prej kolegëve nga pozita me e marrë seriozisht si propozim dhe pse jo mos me shtu kontrollin, raportin dhe me bë punë edhe më cilësore se që jemi duke bërë.

Dardan Berisha - e kam thënë edhe në KPF që realisht ndoshta du me i përkrah këto por janë disa komisione të cilat janë kriju at-hok. Janë komisione të cilat ku të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë dhënë dorëheqje dhe ai komision ka mbet shkak i mos punës tonë. Duhet ta kemi parasysh që ne e kemi obligim me e kontrollu secilën drejtori. Për çdo vërejtje dhe çdo paqartësi janë organet të cilat kanë me u marrë sespe ne nuk e kemi rolin e hetuesit këtu. E kemi propozu që DKA në gusht me dhënë një informatë, nëse është fut në planin e punës. Nëse ne i formojmë këto komisione atëherë pse po ekziston pika e rendit të ditës pyetje dhe përgjigje. Ne te pika pyetje dhe përgjigje mund të diskutojmë për secilën drejtori. Mos po dalim prej konjunkturës së Kuvendit. Nuk e di sa kemi të drejtë sepse e kemi diskutu edhe në KPF që ne kemi të drejtë me formu komisione këshilldhënëse por jo me lu një rol të hetuesit.

Kryesuesi - 31 anëtarët e Kuvendit që jemi, kemi të drejtë me shku dhe me u marrë me këto çështje të ekzekutivit.

Aziz Bytyqi - e kuptoj kërkesën e shefit të gr. të LDK-së dhe qëndrimin e Festës. Nuk është ideja që dikush nuk ka interes me bo punë të mirë për qytetarë. Komuna ka sistem presidencial n' miniaturë në

aspektin kushtetues.Nuk mund ta përdorni në analogji Parlamentin e Kosovës me Kuvendin e Suharekës.S'mund të ushtron kontroll efektiv mbi disa bartës të funksioneve publike për deri sa nuk e ke zgjedh vet.Ne nuk e zgjedhim Kryetarin e Komunës,ne nuk i zgjedhim drejtorat.Këta emërohen nga Kryetari i Komunës ndërsa Kryetari zgjidhet direkt dhe ne n'këtë kuptim nuk mund të krijojmë komisione me një kontroll absolut sepse nuk mund ti shkarkojmë.Sqarime dhe raportime mund të kërkojmë dhe në aspektin e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Festë Kabashi - Komuna e Shtimes i ka veqse këto komisione aktive.Nuk e di a është proceduralisht ose ka mbështetje ligjore,thjesht si iniciativë më është duk personalisht shumë adekuate.Profesor Aziz,unë nuk e di pse po dyshon të paktën në qëllimin tim personal.Unë nuk po kërkoj me kontrollu por po kam dëshirë me qenë më e infromuar si profesioniste e kësaj fushe.Do të thotë,unë punoj në arsim bashkë me ju,bashkë me kolegë të tjerë nga pozita dhe nga opozita.Unë perasonalisht e mbështes këtë iniciativë dhe më duket e qëllume,gjithmonë për me rrit cilësinë,për të marrë informata se çka po ndodh në shkolla ose në institucionet shëndetësore.

Urim Suka - jam i befasuar me qëndrimin që mbajti Azizi.I befasuar jam dhe për faktin sepse e devijoi edhe qëllimin që pata dhe që e kemi dhe që jemi duke e thënë.Nuk kemi kompetenca me shkarku drejtora.As nuk po kërkoj me emru dhe as me shkarku por po kërkoj me formu një komision për me mbikqyr punën e atyre vendimeve që ne i marrim si Kuvend. Ne si opozitë çdo ditë e bëjmë dhe ngrisim shqetësime.Unë po kërkoj me formu një ekip të përbashkët që e shikojmë atë listë të investimeve kapitale që ju po e miratoni sepse ne kemi vërejtje,s'po e miratojmë.a po implementohet siq ju po e miratoni.Ky e bëri me qëllim devijimin,për me i bind asambleistat e vet mos me votu.Kërkesa që po e ngrisim është krejtësisht e bazuar në ligj,është mandat i këtij kuvendi me mbikqyr punën e ekzekutivit çdo ditë.

Aziz Bytyqi - unë nuk thashë që ka qëllim negativ askush por unë e ngrita një paralelizëm lidhur me funksionet tona.Neve nuk na ndal askush ta bëjmë kontroll sistematikë të punëve të ekzekutivit por çështja e komisioneve për mendimin tim nuk është funksionale.Nuk dyshoj në qëllimin e Festës dhe as të një anëtarit.

Vullnet Luzhnica - është e vërtetë që Kryetari ka sistem presidencial por është edhe një e vërtetë që Asamblea është akti më i lartë në Komunë.Edhe nëse këto komisione krijohen,na mundëson me bë vetëm monitorimin dhe kontrollimin sa më të mirë të punës që puna e ekzekutivit me qenë më efikase.Unë nuk besoj që ka telashe dhe mandej a ka produkt apo s'ka,e tregon koha.Kështu që unë jam pro dhe është mirë me u mare seriozisht dhe me u kriju.

Kryesuesi - mua më duken që seancat në ora 10 janë të arsyeshme por do ta kemi parasysh.

Vullnet Luzhnica - unë isha pajtu me qenë në ora 13:00 sepse një numër i madh i kolegëve vijnë nga sektori i arsimit dhe fakti që ne i mbajmë seancat në ora 10:00 më së shumti këtu humbin fëmijët.

Kryesuesi - ka që mbajnë mësim edhe mbasdite por do ta kemi parasysh.

Qëndrim Elshani - duke i marrë parasysh kërkesat e asambleistëve dhe arsyet e tyre,po na duket e arsyeshme edhe grupit tone që me shty fillimin e seancës prej orës 13:00.

Saranda Bajraktari - unë mendoj që kjo është kompetencë e Kryetarit dhe Kryesuesit pasi që oraret nuk janë gjithmonë favorizuese për të gjithë duke e ditë që një pjesë jemi pas orër 13:00.

Kryesuesi - e hedh në votim kërkesën e Urimit që të hyjnë në plan të punës formimi i komisioneve.

**12 për,13 kundër,2 apstenime
Nuk miratohet kërkesa**

Kryesuesi - e hedh në votim kërkesën e Bulëzës për informimin e drejtorive.

12 për,12 kundër,2 apstenime

Kryesuesi e përdor votën e dyfishtë dhe voton kundër.

Nuk miratohet kërkesa

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e Bulëzës që të futet në plan të punës,që seancat solemne të mbahen në sallën e Kuvendit.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 me propozimet që kaluan.

15 për, 9 apstenime
Miratohet pika 4

Flamur Bytyçi - propozoj të ndryshohet statuti i Komunës për vitin e ardhshëm.

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

Kryesuesi - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedhë në votim pikën 5.

Me 23 vota për miratohet pika 5

Pika 6. Njoftim për kontratat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë.

Urim Suka - tani kur e shikon këtë njoftim konstatojmë që shqetësimet që unë ngrita seancën e kaluar lidhur me mos raportimin e Kryetarit për kontratat e nënshkruara për të cilat nuk mora përgjegjësi janë të sakta. Fakti që ky njoftim ka ardhë me informata që nga viti 2018 deri më vitin 2023 le të kuptohet që asnjëherë nuk kemi pas një njoftim të tillë nga ky pushtet. Dua të bëj disa pyetje për këtë pushtet. Në këtë njoftim figuron që për secilën kontratë të nënshkruar, operatorët ekonomikë kanë obligimet e tyre të parapara në secilën kontratë veq e veq. A janë duke u paguar obligimet e qerasë të të gjithë këta operatorë apo shfrytëzues të pronës publike sipas kontratës që keni njoftuar? Nëse jo, cilat masa janë marrë nga ju?

A janë duke u përmbushur kontratat ashtu siq janë lidhur apo kemi devijim të destinimit për çka janë lidhur këto kontrata? Nëse ka devijim të destinimit, cilat janë masat që janë marrë nga ekzekutivi? A ka prona publike që janë të uzurpuara dhe shfrytëzohen ilegalisht duke i përdorur ato e duke mos i paguar obligimet e Komunës? Unë besoj që ka plot dhe kjo dukuri është mjaft shqetësuese sepse në të njëjtën kohë kemi disa shfrytëzues të pronës publike që paguajnë obligimet e disa janë uzurpatorë të cilët as që i nguc kush dhe vazhdojnë ilegalisht të shfrytëzojnë pronat publike. Unë e di që këto çështje janë sfiduese për tu trajtuar sepse janë probleme të grumbulluara mirëpo kjo nuk do të thotë që duhet të vazhdohet të ecet pafundësisht duke mos bërë asgjë sepse nëse vazhdohet kështu ne me mos veprimet tona po i stimulojmë uzurpatorët e po i ndëshkojmë ata që ligjërisht po i shfrytëzojnë pronat publike. Andaj dua të di se cili është plani juaj për të dhënë zgjidhje këtyre problemeve?

Armend Krasniqi - është e vërtetë që i kemi të gjitha ato problematika të cilat i përmende. Kemi një listë të përpiluar ku figurojnë 1085 uzurpator në komunën tonë dhe është shqetësuese. Jemi marrë me këtë problematikë por faktikisht edhe nëse qohemi kreu Suhareka është problem me zgjidhje. Drejtori tuje jep sqarime dhe thotë që këtu nuk duhet të punojë vetëm drejtori por duhet të përfshihet një mekanizëm i madh. Kemi borgje të mëdha mirëpo kjo nuk më përket mua sepse është sektor tjetër që duhet të përgjigjet. Sa i përket informatës të raportimit të pronave dhe shkëputjes së kontratave në këtë kuvend, është e vërtetë që për herë të parë që nga pas lufta është bërë një raportim i tillë.

Urim Suka - drejtori elaboroi situatën dhe u pajtu me ato që ngrita unë. Ishin tri pyetje konkrete ku te njëra drejtori konstatoi që ka borgje por nuk konstatoi për hapat që janë ndërmarrë. Si pyetje që i rrumbullakson të tria ishte: E di vështirësitë që i ka, aq më tepër drejtori por edhe Kryetari ka vështirësi me uzurpatorët sepse nuk ka ndodh sot por unë nuk dua të pajtohem me një situatë ku ne dorëzohemi. A ka një plan ky pushtet se si me iu qas kësaj situatë?

Armend Krasniqi - faktikisht ne veprimet i bëjmë sipas ligjeve në fuqi. Kemi plan për çdo pikë e cila trajtohet në pronë. Kemi plan për uzurpime, shpronësime, këmbime, për regjistrime të pronave në

bashkëpronësi të burrit dhe gruas etj. Mirëpo te çështja e uzurpimit e kemi një ligj të vitit 1977 ku ligji ka lënë dhe lë shumë për të dëshiruar se çka duhet të bëhet me atë ligj. Unë pajtohem që duhet me u trajtu dhe duhet me u mbledh dikasterët më të fuqishëm të Kosovës. Te çështja e uzurpimit a kemi plan? Po kemi plan. Hajde nesër Urim dhe bashkë e zgjidhim vetëm një plan. E lirojmë vetëm një uzurpator ku e dime e gjithë komuna e Suharekës dhe shkojmë i thojmë se duhet me liru pronën brenda 30 dite kur zotëria i ka investu 3 milion euro. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket uzurpimit të pronave publike.

Pika 7 shtesë;

Reshat Selimaj - këtë pikë e kam fut si shtesë duke u konsultuar me disa prej komunave dhe e kam propozu që të jetë ai model këtu. Ne në vitet paraprake i kemi pas 24 mbledhje që ka qenë 50€ seanca dhe ne si kolegë e kemi diskutu me disa Komuna dhe kemi ardhë në përfundim që atë model me ndjek, që të jetë 200€ për seancë medita. Kërkoj mbështetjen e kolegëve.

Kryesuesi - kërkesa e anëtarëve është që t'ju rritet medita e takimit në vlerë 200€ ku brenda vitit kalendarik ti kenë 6 takime. Hap debatin.

Urim Suka - cila është baza ligjore? Unë mendoj që meditet i rregullon ndonjë ligj. Unë nuk mendoj që ne e qojmë dorën dhe e bëjmë një votim sa të na merr mendja. Unë nuk besoj që kemi të drejtë.

Reshat Selimaj - unë tash që jam konsultu me disa komuna. Sa i përket a kemi të drejtë, Kuvendi vendos për pagën tone. Jam konsultu edhe me zyrtarin ligjor në drejtorinë e Armend Krasniqit.

Avni Bytyqi - nuk është e vërtetë që jeni konsultu me mua.

Kryesuesi - kërkon nga zyrtari ligjor sqarime se a kanë të drejtë të votojnë anëtarët e komisionit.

Avni Bytyqi - ligji për ndërmarrjet publike është kompetent që Kuvendi ta themeloj komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike kur komuna është aksionar. Në këtë rast në ndërmarrjen publike "Stacioni i Autobusave" komuna është aksionar 100%. As ligji për ndërmarrje publike dhe as një ligj tjetër sekondar, bazik apo çoftë ndonjë udhëzim administrativ nuk e rregullon çështjen e kompenzimit të anëtarëve të komisioneve që e themelon kuvendi dhe as ligji i pagave. Ligji i pagave e rregullon vetëm për dy komitetet obligative, atë të KPF-së dhe Komitetit për Komunitetet. Është në kompetencën e Kuvendit të përcaktojë sa mirëpo duke bërë një analizë që mos ta dëmtojë organizatën buxhetore. Sa i përket çështjes së konfliktit të interesit, ligji për vetqeverisje lokale e rregullon në mënyrë dicidive. Kur një anëtar i kuvendit e ngrit një çështje për të cilën anëtar i familjes ose vet personalisht ka interes material, duhet ti shmanget procesit të votimit. Zyrtari ligjor lexon dispozitën ligjore.

Flamur Bytyçi - kjo që tha Avniu është shkel nja njëqind herë. Shumë komisione janë themelu këtu te ne dhe unë e kam votu veten aty për me i marrë 50€ meditje. A është kjo shkelje?

Avni Bytyqi - jo sepse ky ka direkt e ata indirekt interes personal.

Reshat Selimaj - nëse është është pikë e ardhur nga unë, unë kërkoj të futet në emër të grupit. Sa i përket zyrtarit ligjor se çka tha, ne të gjithë e votojmë veten në komisione dhe nuk është konflikt.

Elmaze Bytyqi - a bën 135 € sa është seanca sepse 200€ është shumë.

Kryesuesi - Reshati e ka thënë një propozim dhe ne mund të bisedojmë.

Urim Suka - unë e kuptoj shqetësimin që kanë. 25 € meditje është pak dhe jam pro shqetësimit. Unë jam tu e ngrit atë që tha zyrtari ligjor. Ne kemi formu plot komisione dhe me na ardhë kërkesat individuale të secilit komision, është një vendim gabim. Mendoj që duhet me bë një meditje që vlen për të gjitha komisionet.

Reshat Selimaj - Malisheva këtë vendim e ka marrë para një muaji. Kërkoj 5 min. pause të diskutojmë si grup.

Kryesuesi - faktikisht ne po e diskutojmë vetëm vlerën sa.

Reshat Selimaj - vlera është sikur të gjitha komunat që kemi diskutu. Nuk e dëmton buxhetin asnjë cent.

Dardan Berisha - ne e formuam një komision paraprakisht por komisioni është me mandat vetëm për këtë vendim. Në këtë rast e kemi edhe te bonus banimi ku po e përcaktojmë vet shumën si kuvend. Ne nuk kemi asnjë vendim personal të Reshatit me shkrim dhe mund të propozoj shefi i grupit të asambleistëve në këtë rast dhe me e fuqizu vendimin e Reshatit.

Shefket Kolgeci -nuk besoj që duhet me qenë një medijtje ndryshe dhe një ndryshe.Një komision që ekziston çmimi më i lartë,le t'ju bëhet dhe këtyre.Me bo një komision si po thotë Reshati,unë nuk jam kundra por të gjitha komisionet kanë me kërkun nga 200€ medijtjen dhe tani do të bie ndesh me vendimet e kësaj asambleje.Hedhne në votim dhe shumica vendos.

Flamur Bytyçi - parimisht pajtohem me propozuesin por ndoshta për vlerë nuk pajtohem.Është mirë me pas një lloj barazie.Është mirë që të shtyhet për seancën tjetër dhe të rregullohet çështja për secilin komision,t'ja bëjmë një vlerë.Nuk është në rregull dikush me u pagu e dikush jo.

Aziz Bytyqi - kërkesa e Reshatit është kthimi në gjendje të mëparshme,siq ka qenë të kaluarën.Nuk besoj që ne kemi të drejtë që ne në të gjitha komisionet me rrit medijtjen.P.sh komisionin për bursave është e caktuar me ligj që ke të drejtë me i mbajtë vetëm 6 seanca.Nuk e di a kemi të drejtë por nëse kemi të drejtë është e vërtetë që krijohet precedentë.Komisioni i bursave kanë shumë punë më shumë se sa 6 seanca.Nëse kemi të drejtë unë kisha kërkun që komisionit për shqyrtimin e bursave me iu leju sa të mbajnë seanca me u pagu.

Avni Bytyqi - asnjë ligj dhe asnjë rregullore nuk e rregullon çështjen e kompenzimeve për komisionet që themelohen nga kuvendi përpos dy komiteteve obligative. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Aziz Bytyqi - zyrtar ligjor më kujtohet që kur kemi ardhë në vitin 2021 pas zgjedhjeve,neve na është interpretuar që nuk kemi të drejtë më shumë se 6 seanca.Kjo është arsyeja që jemi ndal në 6 sepse komisioni për bursa në të kaluarën i kanë mbajtë 7 apo 8 seanca dhe janë pagu.

Avni Bytyqi - caktoni vlerën sepse është kompetencë e juaja mirëpo jo më shumë se 6 takime.

Reshat Selimaj - ne si komision i aksionarëve ndodh që tre herë në ditë shkojmë atje sepse ka probleme.Ti si zyrtar ligjor kur kemi votu me u formu kjo është desh me m'thanë që është konflikt interesi.Ti je duke e bë me tendencë.

Avni Bytyqi - kërkesa ka ardhë direkt prej teje.

Qëndrim Elshani - parimisht pajtohem me Reshatin sepse medijtja është e ulët mirëpo pajtohem edhe me Flamurin që thotë që secili komision duhet me iu përshtat medijtjes së vet.Ne dime që ka komisione që nuk paguhet.Unë mendoj që duhet një përshtatje për të gjitha komisionet dhe kjo duhet me ardhë si pako mbledhjen tjetër apo kurdo që është gati sepse nëse i hym secilit komision veq veq bëhet llugë dhe nuk besoj që është e udhës.

Reshat Selimaj - në mandatet e kaluar unë kam punuar 25 ditë nga AAK,Zana Basha nga VV dhe Agim Bujari nga PDK për emërtimin e rrugëve dhe asnjë cent nuk e kemi marrë.Këtu e kam një model dhe kërkun me mbështet.

Flamur Bytyqi - këtu unë kam propozu që me u bë komitete për secilën drejtori dhe krejt ju që jeni këtu e keni kundërshtu atë vendim.Tash po bini në atë pikë që unë e kam kërkun më herët.

Laureta Tafaj - unë dua të dal me një propozim.Ose le të bëhet e barabartë me komisionet tjera 50 € për medijtje ose le të bëhet sikur medijtja e seancës.

Kryesuesi - Laureta e dha një propozim që të barazohet me një takim të një seance të Asamblesë dhe kërkesa e anëtarëve të komisionit me vlerë prej 200€ të jetë brnda 6 seancave.

Reshat Selimaj - kryesues,jo kërkesa e anëtarëve por unë të thash që e kam marrë model në 5 komuna.

Kryesuesi - kërkesa ka ardhë në emër të grupit të aksinerëve dhe ju e keni parapa 200€.

Bulëza Kuçi - kur po është fjala për komunat tjera,ne nganjëherë s'po i përfillim e sot po dojket me i përfill.Ose po i fusim edhe kërkesat tona për krejt komisionet.

Kryesuesi - dolën dy kërkesa,200 dhe 153.

Bulëza Kuçi - unë për vete jam në disa komisione që nuk paguhem asnjë cent e disa 200€.

Saranda Bajraktari - personalisht mendoj që kjo medijtja me vlej të për të gjitha komisionet.Unë personalisht kam marrë pjesë në komisionin për formimin e këshillave të fshatrave ku kanë qenë 40 fshatra dhe janë mbajtë 40 takime dhe nuk jemi pagu fare.Në një formë i bie një lloj diskriminimi.

Reshat Selimaj - para se të hidhet në votim unë dua një sqarim nga zyrtari ligjor se a kemi konflikt interesi në këtë kërkesë dhe a kemi të drejtë me votu apo jo.

Avni Bytyqi - e dhash sqarimin ligjor dhe e lexova decidivisht dispoziten ligjore. Është çshtje e jotja se a tërhiqes apo nuk tërhiqesh.

Shefket Kolgeci - grupi jonë propozoj,Flamuri propozoj dhe Bulëza tha.Ju lutem ta shqyrtoni këtë situatë me të gjitha grupet dhe mbledhjen e ardhshme bjerne,e diskutojmë dhe e votojmë.

Dardan Berisha - n'pikën e parë ne e votuam vetëm një kërkesë.Mos po dalim jashtëligjshëm që me votu kërkesa tjera.Kërkesat tjera le të mbesin seancën e ardhshme kush ka kërkesa.

Kryesuesi - sipas zyrarit ligjor propozimin e dytë duhet ta sjellim në një seancë tjetër sepse nuk është në rend dite.E hedh në votim që kërkesa e Reshatit të aprovohet.

14 për, 8 kundër,1 apstenim Miratohet kërkesa

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Urim Suka - fjala është për miratimin e buxhetit të Komunës nga Kuvendi në seancën e jashtëzakonshme të 2 tetorit e cila erdhi si rrjedhojë e manipulimit të votave të seancës së 28 shtatorit.Siq e dini në seancën e jashtëzakonshme të 2 tetorit disa nga kuvendarët e pushtetit të cilët kishin votuar kundër në seancën e 28 shtatorit dolën me disa propozime të projekteve konkrete në këmbim të votes pro buxhetit.Këto propozime të kuvendarëve u propozuan një nga një dhe u votuan ndërsa në fund u miratua edhe buxheti në tërësi.Të dashur kuvendar dhe qytetarë,ditë më pare unë e kam marrë buxhetin siq është miratuar dhe siq është aprovuar nga ministria.Pas analizës në detaje që i bëra këtij buxheti unë nuk pash askund propozimet e kuvendarëve të seancës së jashtëzakonshme të 2 tetorit.Propozimet e tyre nuk janë përfshirë fare në dokumentin final të buxhetit.Kjo dukuri është tepër shqetësuese,e papranueshme dhe në kundërshtim me secilën normë demokratike e ligjore dhe është manipulim i vullnetit të kuvendarëve për të dytën herë radhazi.Pres sqarimet tuaja dhe uroj që ta arsyetoni e demantoni pretendimin tim për këtë çështje, ndryshe demokracia dhe zhvillimi demokratik i komunës toë po fundoset me paramendim nga ky pushtet.A janë të përfshira në buxhet këto propozime?nëse po,ku?nëse jo kërkoj interpretime nga zyrari ligjor meqenëse këto propozime nuk janë inkorporuar në buxhet.A mund të llogaritet që ky buxhet nuk është miratuar fare sepse këta kuvendar kanë deklaruar qartë që nëse nuk përfillen këto propozime,vota e tyre është kundër.Pyetja e dytë lidhet me mproblematikën e kanalizimit me fshatitn Reshtan,përkatësisht nga vrella e fshatit aty ku furnizohen me ujë qytetarët.Cili është plani juaj që të merrni masa serioze për të parandaluar një problem serioz në këtë hapsir sepse neglizhenca e saj mund të shkaktoj dëme të drejtëpërdrejta tek qytetarët sepse nga aty furnizohen një numër i madh i tyre me ujë?Pyetja e tretë është për Kryetarin dhe ka të bëj me ndriçimin publik.Këto ditë Kryetari ka bërë përrurimin e disa pjesëve të ndriçimit publik,në Delloc dhe Budakovë.Shqetësimi im është fakti që gjatë këtyre përrurimeve janë përdorur fëmijët në këto aktivitete.Ajo që më shqetëson më shumë është fakti që këta fëmijë janë përdorur që ti lëshojnë dritat duke futur dorën në kutinë e siguresës aty ku bëhej lidhja e rrymës për ndezjen e dritave.Ky veprim është i çuditshëm dhe i papranueshëm sepse është çështje sigurie dhe nuk duhet të përsëritet asnjëherë.Kur jemi te ndriçimi dua të njoftoj Kryetarin dhe secilin prej jush se përkundër ndërrimit të disa llampave elektrike në Bllacë vazhdon me pas probleme të mëdha me ndriçim publik,madje as të rejtat nuk janë funksionale ndërsa sipas ankesave të qytetarëve problem me ndriçim publik janë në shumë vendbanime.Në fund dua të di nga drejtori i bujqësisë se ku ka mbërritur me procedurën e tenderimit për trajtimin e qenve endacak sepse muajin e kaluar tha që kam filluar një procedure të re.Dua të shpreh një keqardhje t'imen për mungesën e një numri të madh të asambleistëve në këto adresime që po i bëjmë sot për faktin se një numër i madh për disa asambleist ,më interesant ishte me ditë meditja e tyre në komisionet ku janë se sa me i ndëgju hallet dhe interesat e qytetarëve.

Kryesuesi - sa i përket buxhetit është shqetësuese por ajo është çështje e ekzekutivit dhe s'mund të jap përgjigje.Ne e kemi miratu dhe është aprovu edhe nga ana e ministrisë.Te ndriçimet publike që Kryetari i promovon,a ka të drejtë a s'ka është kompetencë e Kryetarit.Shqetësimi te vrella e ujit në Reshtan,nëse ka marrë ndonjë ankesë drejtoresha e inspeksionit le ta jep një sqarim.

Albulena Kokollari - nuk ka pas ankesë.

Kryesuesi - te bujqësia drejtori nuk është këtu dhe nuk mund të përgjigjem

Urim Suka - çështjet që i ngrita janë tepër serioze e sidomos çështja e buxhetit. Më vie keq që asambleistët që i kanë bërë propozimet nuk janë këtu. Me i votu propozimet një nga një dhe mos me reflektu n' buxhet, kjo është më tepër se shqetësuese. Me qenëse po mungojnë shumica e drejtorave, dua që për secilin shqetësim që ngrita, në seancën e ardhshme të japin përgjegje ose le ta bëjnë një përgjegje me shkrim. Te drejtoria e Inspeksionit me sa unë e di banorët janë anku. Si rezultat i ankesës aty është intervenu por ky problem po përsëritet qe dy herë. Vrella ku furnizohen Reshatni dhe një pjesë e Suharekës me ujë të pijes, nëse lihet ashtu dhe nëse ai kalnalizimi që po zihet dhe po bje uji aty, problemi për mu infektu mundet me ndodh shpejt. Andaj është mirë të mirret më seriozitet dhe me mujt me zgjidh para se me ndodh fatkeqësia.

Flamur Bytyqi - te uzurpimet e evidentuara a ke ndonjë raport se në cilën kohë kanë ndodh këto uzurpime, specifikisht gjatë mandatit tuaj a kanë ndodh këto?

Armend Krasniqi - gjatë mandatit tim nuk ka ndodh dhe nuk ka guxu as me mendu me ndodh asnjë uzurpim i vetëm. Raporti se kur kanë ndodhë, fatkeqësisht është që nga vitet '60-ta, '70-ta, '80-ta, '90-ta. 2000. 2021. Kur kam ardhë unë janë nis nja dy dhe kanë mbet ashtu dhe shumë shpejt besoj që kanë me u rrëzu.

Takimi përfundoi: 12:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj